

Rregullat e Procedures per Ndermjetesimin
Arbitrazhi dhe Ndermjetesimi Tregtar

PJESA I

PERKUFIZIMET, FILLIMI I PROCESIT, EMERIMI I NDERMJETESIT

Perkufizimet

- 1. Ne keto rregulla, ne qofte se konteksti nuk e kerkon ndryshe,**
a."Dite" do te thote nje dite e plote 24 oreshe, por nuk e perfshin te Shtunen, te Dielen ose nje dite qe eshte dite kombetare pushimi ne Shqiperi; b. "Qender" do te thote Qendra Shqiptare Ndermjetesimit dhe Arbitrazhit Tregtar; c."Ndermjetesim" do te thote perdorimi i nje pale te trete te paanshme, per te ndihmuar palet te zgjidhin nje mosmarreveshje;
d. "Marreveshje Ndermjetesimi" do te thote marreveshje e shkruar midis paleve, ose nje klauzole ose parashikim ne nje marreveshje te shkruar midis paleve, e cila kerkon referimin e mosmarreveshjeve te tashme ose te ardhshme midis tyre, per ndermjetesim; e."Ndermjetes" do te thote nje person ose persona te paanshem, te angazhuar te ndihmojne palet te zgjidhin nje mosmarreveshje;
f."Rregullat" do te thote keto Rregulla te Qendres per Zhvillimin e Ndermjetesimit Tregtar;
g."Marreveshja e Zgjidhjes" do te thote nje marreveshje e shkruar e ekzekutuar nga palet, me keshillimin e juristit kur kerkohet, e cila zgjidh, pjesisht ose plotesisht, mosmarreveshjen midis tyre.

Fillimi i Ndermjetesimit

- 2.kane parashikuar, me marreveshje, per ndermjetesimin e mosmarreveshjeve te tyre ekzistuese ose te ardhshme ne perputhje me keto Rregulla, do te konsiderohet qe ato i kane perfshire keto Rregulla ne Marreveshjen e tyre te Ndermjetesimit.
3.Ndonje pale ne mosmarreveshje mund te filloje ndermjetesimin sipas ketyre Rregullave duke dorezuar nje kerkese te shkruar per ndermjetesim ne Qendren, e cila do te perfshije:
a.emrat, adresat, numrat e telefonit dhe faksit dhe adresat e e-mail-it te paleve ne mosmarreveshje dhe perfaqesuesit e tyre, ne qofte se kane;
b.nje pershkrim i mosmarreveshjes duke perfshire, ne qofte se eshte e mundur, nje vleresim te vleres se saj;
c.nje kopje te Marreveshjes te Ndermjetesimit, ne qofte se ka; dhe
d.tarifen perkatese sic percaktohet ne tabelen e taksave te Qendres.
4.Kur kerkesa per ndermjetesim nuk dorezohet se bashku nga te gjitha palet, pala ose palet qe dorezojne Kerkesen, do t'ja dergojne njekohesisht ate dhe pales ose paleve te tjera.
5.Qendra duhet te beje menjehere te ditur me shkrim paleve, marrjen e kerkeses per ndermjetesim.
6.Kur nuk ka marreveshje midis paleve per t'ia referuar mosmarreveshjen e tyre per ndermjetesim Qendres, ndonje pale ose palet qe deshirojne te fillojne proceset e ndermjetesimit ne perputhje me Rregullat, duhet ti dergojne Qendres nje kerkese te shkruar per ndermjetesim, ne te cilen do te perfshihen:

a.emrat, adresat, numrat e telefonit dhe faksit dhe adresat e e-mail-it te paleve ne mosmarreveshje dhe perfaqesuesve tyre, ne qofte se kane;

b.nje pershkrim i mosmarreveshjes duke perfshire, ne qofte se eshte e mundur, nje vleresim te vleres se saj; dhe

c.tarifen perkatese percaktuar ne tabelen e taksave te Qendres.

7.Qendra duhet menjehere te informoje me shkrim palen ose palet e tjera ne lidhje me kerkesen per ndermjetesim. Pales ose paleve te tilla do ti kerkohet qe te informojne me shkrim Qendren, brenda 15 diteve pas marrjes te kerkeses per ndermjetesim, per faktin ne se ato bien dakort ose jo te fillojne ne procedimin e ndermjetesimit.

8. Ne mungese te ndonje pergjigjeje brenda nje kohe te tille prej 15 ditesh, ose ne rastin e ndonje pergjigjeje negative, kerkesa per ndermjetesim do te konsiderohet qe nuk eshte pranuar dhe procedimet e ndermjetesimit nuk do te fillojne. Qendra duhet menjehere te informoje me shkrim palen ose palet te cilet kane dorezuar kerkesen per ndermjetesim.

Emerimi i Ndermjetesit

9.Ne qofte se Marreveshja e Ndermjetesimit emeron nje Ndermjetes ose specifikon e nje procedure per caktimin e nje Ndermjetesit, ai emerim ose procedure do te aplikohet.

10. Ne qofte se Marreveshja e Ndermjetesimit nuk emeron nje Ndermjetes ose nje procedure specifike per emerimin, palet mund ti kerkojne Qendres emerimin e nje Ndermjetesit. Qendra mund tu paraqese paleve CV-te e dy ose tre ndermjetesve, te cilet jane te disponueshem per te ndermarre ndermjetesimin. Ne qofte se palet nuk arrijne te bien dakort per caktimin e Ndermjetesit, atehere ai do te emerohet nga Qendra.

11. Qendr do te informoje menjehere ndermjetesin per zgjedhjen e tij ose te saj. Ne qofte se Ndermjetesit i emeruar sipas (1) me siper, per ndonje arsye, nuk eshte ne gjendje te veproje, Qendra do te emeroje nje Ndermjetes tjeter. Ne qofte se Ndermjetesit i emeruar sipas (2) me siper, nuk eshte ne gjendje, per ndonje arsye, te veproje, Qendra dhe palet do te perserisin proceduren e percaktuar ne (2). Tarifa e pershtatshme e administrimit sic percaktohet ne tabelen e tarifave te Qendres, do ti paguhet Qendres per keto sherbime.

12.Perpara se te pranohet nje emerim, nje Ndermjetes duhet te beje te ditur ndonje interes personal ne mosmarreveshje, ndonje njeanshmeri ose rrethane qe mund te coje ne premiset e njeanshmerise ne ato rrethana.

Letra e Angazhimit

13.Neqofte se eshte e nevojshme, Qendra ose Ndermjetesit duhet te pregatise dhe te zbatoje se bashku me palet nje leter angazhimi qe percakton;

a. termat dhe kushtet sipas te cilave palet angazhojne Ndermjetesin;

b.ndonje nga keto Rregulla, te cilat nuk do te zbatohen ne ndermjetesim; dhe

c.rregullat shitese te cilat do te zbatohen ne Ndermjetesim.

PJESA II

ZHVILLIMI I NDERMJETESIMIT

Koha dhe Vendi

14.Ndermjeteresi, pas konsultimit me palet, duhet te caktojë oren e cdo takimi te ndermjeteresimit. Te gjitha takimet do te mbahen ne nje vend takimi te pershtatshem per palet dhe Ndermjeteresin, sic do te vendoset nga Ndermjeteresi.

Autoriteti i Ndermjeteresit

15.Ndermjeteresi do te perpiqet te ndihmoje palet te arrijne nje zgjidhje te kenaqshme te mosmarreveshjes se tyre por nuk ka autoritet tu imponoje paleve nje zgjidhje. Ndermjeteresi eshte i autorizuar te zhvilloje takime te perbashketa dhe te vecanta me palet dhe te bejne rekomandime per zgjidhje.

16. Ndermjeteresi mund te therrase eksperte ose konsulente, ne qofte se palet bien dakort dhe pranojne pergjegjesite per shpenzimet e ketyre eksperteve ose konsulenteve.

Perfaqesimi dhe Autoriteti per te Vendosur per Mosmarreveshjen

17. Nje pale muned te perfaqesohet nga nje avokat ose agent me kusht qe emri dhe adresat e ndonjerit dhe te gjithë ketyre perfaqesuesve te jene komunikuar me shkrim, te Ndermjeteresi dhe te te gjitha palet perpara takimit te pare te Ndermjeteresimit.

18. Ne qofte se nuk eshte vendosur ndryshe nga te gjitha palet, perfaqesuesit e paleve qe marrin pjese ne ndermjeteresim, kane autoritet te plote te pacilesuar per te arritur nje zgjidhje te mosmarreveshjes.

Fshehtesia

19. Ndermjeteresimi do te zhvillohet ne ambjentet e Qendres ose ne ndonje vend tjeter privat per te cilin palet kane rene dakort bashkarisht. Persona te tjere pervec paleve, perfaqesuesve te tyre dhe Ndermjeteresit, mund te marrin pjese vetem me pelqimin e te gjitha paleve dhe Ndermjeteresit.

Konfidencialiteti

20.Ndermjeteresi duhet te mbaje konfidencial cdo informacion te bere te ditur ne vazhdim te ndermjeteresimit, duke perfshire te gjitha materialet e shkruara qe i jepen atij si Ndermjeteres.

21. Palet bien dakort qe sesionet e ndermjeteresimit jane zgjidhje me negocime dhe publikimi i te dhenave ne ndonje procedim gjyqesor ose arbitral te mevonshem, eshte i papranueshem per aq sa lejohet nga ligji. Palet bien dakort qe te mos bejne kerkese me shkrim ose ne ndonje menyre tjeter ti kerkojne ndermjeteresit qe te deshmojne ose te pregatise rregjistrime ose shenime per ndonje procedim ne te ardhmen. Asnje transkriptim nuk do te mbahet gjate procedimeve.

22.Palet bien dakort qe ato nuk do te mbeshteten ose te paraqesin si deshmi ne procedime te mevonshme arbitrale ose gjyqesore:

- a.Ndonje opinion te shprehur ose sugjerim te bere nga pala tjeter ne lidhje me zgjidhjen e mundshme te mosmarreshjes;
- b.Ndonje pranim te bere nga pala tjeter gjate zhvillimit te ndermjetesimit; c.Faktin qe pala tjeter eshte pranuar e gatshme te pranoje nje propozim ose rekomandim per zgjidhje te bere nga ndermjetesi; ose
- d.Propozime te bera ose opinione te shprehura nga Ndermjetesi.

Perfundimi i Ndermjetesimit

23.Ndermjetesimi duhet te mbaroje:

- a.nga ekzekutimi i marreshjes se zgjidhjes nga palet;
- b.nga nje deklarate e shkruar nga nje ose me shume pale qe ndermjetesimi ka perfunduar;
- c.nga nje deklarate e shkruar nga Ndermjetesi qe perpjekjet e metejshme ne ndermjetesim, nuk do te jene te vlefshme.

Perjashtimi i Pergjegjesise

24.As Qendra e as Ndermjetesi nuk do te jene pergjegjese ndaj ndonjeres nga palet per ndonje veprim ose mos veprim ne lidhje me ndermjetesimin e zhvilluar sipas ketyre Rregullave.

Tarifat dhe Shpenzimet

25. Shpenzimet e eksperteve ose deshmitareve te tjere qe marrin pjese ne ndermjetesim do te jete pergjegjesi e pales qe ka organizuar pjesmarrjen e ketij personi.

26.Tarifa e Ndermjetesit dhe te gjitha shpenzimet e ndermjetesimit, duke perfshire shpenzimet e udhetimit dhe qerane e ambjenteve e kostot dhe shpenzimet e ndonje eksperti ose konsulenti te thirrur nga Ndermjetesi sipas paragrafit 16 ketu, ne qofte se ka ndonje, do te mbulohet ne menyra te barabarte nga palet, ne qofte se ato nuk kane rene dakort ndryshe.

27.Ne qofte se palet nuk kane bere nje marreshje te kundert, Tarifa e regjistrimit do te paguhet ne pjese te barabarta nga palet.

28.Kur nje tarife administrative i duhet paguar Qendres, ajo duhet te mbulohet ne menyre te barabarte nga palet.

SOURCE: WWW.ARYME.COM